

**VENDIM**  
**Nr. 69/2024**

**PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË  
TË PROKURORISË NGA RADHËT E AVOKATËVE SIPAS LIGJIT NR. 115/2016  
“PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”,  
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 149, pika 8, të Kushtetutës, nenit 35, pika 16, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Të konsiderojë të zgjedhur kandidatët e listës së tretë në bllok për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve, që kanë rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

1. Erind Mercuri
2. Erind Gërmenji

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Lindita Nikolla**

Miratuar në datën 25.7.2024